



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2021:199878

Datë: 04.11.2024

Numri i dokumentit: 06459621

P.nr.779/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, në lëndën penale të akuzuarve S.A. i akuzuar për veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 315 par nen par 2.1, L.P. për veprën penale Ndhurma në kryerjen e veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 315 par nen par 2.1, F.J. për veprën penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par 2 dhe G.H. për veprën penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par 2 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.4191/21 të datës 12.08.2022, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 02.10.2024 në praninë e Prokurorit të Shtetit Kastriot Berisha dhe të pandehurve S.A. me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare av. Bajram Zogiani, L.P. me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare av Daut Behrami, F.J. dhe G.H. me datë 04.10.2024 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 04.11.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari S.A. , nga i ati T., e ëma L., i lindur më datë në Prishtinë, me adresë banimi në lagjen nr.... në F.K ka të përfunduar vetëm 8 vite të shkollës fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, romë, shtetas i Republikës së Kosovës me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Ekziston dyshimi i bazuar mirë se në intervalin kohorë prej datë s 05 deri 07.09.2021 rreth orë s 12:00 dhe 19:30 në Zonën Industriale në F.K . më saktësisht në objektin – depo “VSH” Sh.p.k pronë e të dëmtuarit M.A. i pandehuri S. me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme veti ti sjellë përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme në ditën kritike ka shkuar në vendin e ngjarjes ka vepruar në atë mënyrë që duke përdorur forcën me një mjet tani për tani të paidentifikuar ka thyer xhamin e depos ka depërtuar brenda dhe nga aty ka vjedhur gjësende të ndryshme si 168 doreza (brava) të dyerve, 211 pako të thonjë (kozmetikë), 9 copë gell për thonjë , 8 dyer, 8 korniza të dyerve, 73 pllaka qeramikë , në vlerë të përgjithshme prej 6900 euro me ç’ rast të dëmtuarit M. i ka shkaktuar dëm material në vlerën e theksuar.

- Me këtë i pandehuri e ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 315 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 70, 71, 72 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

GJYKON

- I. Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite i cili dënim do të ekzekutohet pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës se prerë.
- II. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. I dëmtuari M.A. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet që ta realizon në procedurë të rregullt civilo-juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP/II.nr.4768/21 të datës 07.06.2022, ndaj të akuzuarve S.A. i akuzuar për veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 315 par nën par 2.1, L.P. për veprën penale Ndhurma në kryerjen e veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 315 par nën par 2.1, F.J. për veprën penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par 2 dhe G.H. për veprën penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par 2 të KPRK-së të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 04.10.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Kastriot Berisha dhe të pandehurve S.A. me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare Bajram Zogiani, L.P. me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare av Daut Behrami, F.J. dhe G.H. ku të njëjtët u njoftuan me të drejtat e tyre, me aktakuzën dhe provat kundër tyre. Pas kësaj prokurori i shtetit lexoj aktakuzën kundër të pandehurve.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i pandehuri S.A. u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës. Ndërsa të pandehurit L.P., F.J. dhe G.H. u deklaruan të pafajshëm për veprat penale për të cilat akuzohet sipas aktit akuzues.

Me qëllim të efikasitetit të procedurës penale e në harmoni me nenin 35 të KPPRK-së Gjykata pas marrjes së mendimit të palëve në seancën e shqyrtimit fillestar ka bërë veçimin e procedurës penale ndaj të pandehurit S.A. i cili u deklarua fajtorë për veprën penale për të cilën akuzohet, ndërsa ndaj të pandehurit L.P., F.J. dhe G.H. duke qenë se të njëjtët u deklaruan të pafajshëm për veprat penale për të cilat akuzohen, Gjykata njoftoi palët se ndaj të njëjtëve do vazhdohet procedura e ndarë dhe rasti do procedohet sipas dispozitave të KPPRK-së.

Pas deklarimit të pandehurit, mbrojtësit të tij dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë sa i përket të pandehurit S.A. Gjykata konstatoj se i pandehuri ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarit S.A. se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit S.A. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 315 par 2 nen par 2.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 70 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi të akuzuarit, ndërsa rrethana rënduese ishte fakti se i pandehuri është në vuajtje të dënimit për veprë penale të llojit të njëjtë dhe është i dënuar me burgim efektiv si dhe dëmi material të cilin e ka shkaktuar i njëjti me rastin e kryerjes se veprës penale.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim të nenit 40, 42 të KPRK-së te akuzuarin e gjykoi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar te akuzuarit është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit ne pengimin e të pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne të ardhmen veçanërisht llojin e njëjte të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që te përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPRK-së si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 Euro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.779/24 datë 04.11.2024

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashetrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtut. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.